



DREJTOR MENAXHUES I FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

Sfondi

Në korrik të vitit 2014, FMI filloi implementimin e Programit të USAID/Kosovo EMPOWER Përkrahje Kreditore. Programi EMPOWER Përkrahje Kreditore është program trevjeçar për krijimin e një fondi financiarisht të qëndrueshëm të garancive kreditore, që rrit huadhënien e sektorit privat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) që krijojnë vende pune e që kanë potencial të rritjes së lartë në Kosovë, duke përfshirë bizneset në pronësi të grave dhe të pakicave, si dhe ndërmarrësve të rinj. Ky program gjithashtu vepron për të rritur vetëdijen e palëve për ndërmjetësimin financiar dhe veglat për rritjen e biznesit.

Me miratimin e Ligjit nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) (<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11339>), është themeluar subjekti i qëndrueshëm. Në pajtim me Ligjin për FKGK, Bordi i Drejtorëve i FKGK-së ka autorizuar rekrutimin e Drejtorit Menaxhues të FKGK-së, i cili do të shërbejë si KSHE si dhe si anëtar ex-officio i Bordit të Drejtorëve.

Përshkrimi i punës dhe fushëveprimi:

1. Drejtori Menaxhues i FKGK-së është Kryeshf Ekzekutiv i FKGK-së me orar të plotë.
2. Drejtori Menaxhues është sipas ligjit, anëtar në detyrë zyrtare i Bordit të Drejtorëve të FKGK-së, të cilit ai/ajo i raporton përmes Kryetarit të Bordit.
3. Drejtori Menaxhues merr të gjitha vendimet menaxhuese dhe operative për FKGK-në, si dhe është përgjegjës për:
 - 3.1. Përfaqësimin dhe menaxhimin e punëve të FKGK-së dhe implementimin e vendimeve për politikën e Bordit të Drejtorëve;
 - 3.2. Dhënien e rekomandimeve për Bordin e Drejtorëve për ndryshimin e politikave ekzistuese dhe përgatitjen e të rejave, të cilat përmirësojnë më shumë operacionet e FKGK-së, si dhe përputhshmërinë me Ligjin për FKGK-në si dhe rregullat e kriteret tjera në fuqi;
 - 3.3. Përgatitjen dhe propozimin e planit financiar të FKGK-së për shqyrtim nga Bordi i Drejtorëve, duke përfshirë edhe nivelin e tarifave që duhen vlerësuar për institucionet financiare, si dhe dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore para për miratim nga Bordi i Drejtorëve;
 - 3.4. Hartimin dhe dorëzimin e politikave investuese dhe dokumenteve të tjera relevante për miratim nga Bordi i Drejtorëve;
 - 3.5. Paraqitjen e të gjitha veprimeve, rregullave, urdhrave dhe udhëzimeve për miratim nga Bordi i Drejtorëve;
 - 3.6. Shqyrtimin e aktiviteteve të FKGK-së nga perspektiva e vlerësimit të rreziqeve, duke vlerësuar se cilat rreziqe janë të pranueshme dhe duke siguruar vendosjen e masave të mirëfillta të përbaljes me to, të gjitha këto në përputhje

të plotë me dispozitat e Ligjit për FKGK-në; Statutin dhe Politikat e Procedurat e Brendshme në fuqi.

3.7. Kryerjen e të gjitha aktiviteteve tjera në përputhje me Ligjin për FKGK-në si dhe Statutin e FKGK-së dhe Politikat e Procedurat e Brendshme të tij;

4. Drejtori Menaxhues emërohet për një mandat pesëvjeçar (5), me mundësi riemërimi nga Bordi i Drejtorëve në bazë të vlerësimit të punës.

5. Drejtori Menaxhues merr kompensimin e arsyeshëm, të caktuar nga Bordi i Drejtorëve, nga FKGK-ja, në formë të pagës.

Kualifikimet:

Aplikanti duhet të ketë kualifikimet vijuese:

- Së paku dhjetë (10) vjet përvojë në banka e financa, prej të cilave së paku pesë (5) vjet në pozitë menaxhuese;
- Titull universitar në financa, ekonomi apo degë tjetër relevante, titulli i avancuar në ato fusha është i preferuar, por jo i detyrueshëm;
- Përputhshmëria me të gjitha standardet e të qenit i «aftë dhe i përshtatshëm» për pozitën, siç përcaktohet me Ligjin për FKGK-në dhe Ligjin nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-Financiare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare (<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2816>);
- Njohuri e mirë e kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe sfidave të sektorit bankar dhe financiar, fituar përmes përvojës së punës në sektor;
- Njohuri e plotë e rreziqeve kreditore, riskut të likuiditetit, si dhe menaxhimit të rreziqeve operative, të fituar përmes përvojës së punës;
- Përvoja në themelimin dhe funksionalizimin e institucioneve financiare është tejet e preferuar;
- Aftësi të mira të komunikimit në të folur e në të shkruar në gjuhën shqipe apo serbe dhe angleze;
- Aftësi për të punuar në një mjedis pune me orientim ekipor e pjesëmarrës.

Afati për aplikim:

Aplikantët duhet të dorëzojnë një letër motivimi, si dhe biografinë e jetës (CV-ja duhet të përfshijë informatat kontaktuese për së paku tri referenca të verifikueshme profesionale) jo më vonë se ora 16:00, 3 nëntor. Aplikacionet duhen dërguar në këtë adresë elektronike: info@fondikgk.org, ose, të dorëzohen personalisht në adresën e mëposhtme, në zarf të mbyllur.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, zyra në Rr. Anton Çetta 5A, Prishtinë.
Tel: +381 (0) 38 225 600 lok. (208)

Pas përfundimit të procesit të rekrutimit, aplikanti i suksesshëm duhet t'i nënshtrohet një procesi verifikues, për të vlerësuar nëse plotëson kriteret e aftësisë dhe përshtatshmërisë, siç përcaktohet me Ligjin nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-Financiare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare (<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2816>).